



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.6 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Dispozitat e Rregullës për vendosjen e Çmimeve të Gjenerimit;
- Parimet e Vendosijes së Ngarkesave për Gjeneratorët e Rregulluar; dhe
- Kërkesën e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK Sh.A) të datës 06.02.2014 për shqyrtim dhe aprovim të dokumentit “Metodologjia e Përcaktimit të Ngarkesave për Gjeneratorët e Rregulluar”.

Në seancën e mbajtur me datë 29 prill 2014, nxori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET METODOLOGJIA E PËRCAKTIMIT TË NGARKESAVE PËR GJENERATORËT E RREGULLUAR

A R S Y E T I M

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 18.02.2014 ka pranuar kërkesën nga KEK Sh.A. për aprovim të Metodologjisë për Përcaktimin e Ngarkesave për Gjeneratorët e Rregulluar.
 - ZRRE ka qenë e kyçur gjatë tërë kohës së hartimit të dokumentit dhe ka dhënë komentet e veta gjatë takimeve drejtpërdrejt, por dhe në formë të shkruar.
 - Zyra e Rregullatorit për Energji me date 19.03.2014 iu ka dërguar për komente Metodologjinë për Përcaktimin e Ngarkesave për Gjeneratorët e Rregulluar të licencuarve KEDS dhe KOSTT.
 - Zyra e Rregullatorit për Energji ka pranuar komentet nga të Licencuarit, dhe pas vlerësimit të tyre dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në diapozitiv të këtij vendimi.
- II.** Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- III.** Obligohet KEK SH.A. që dokumentin Metodologjia e Përcaktimit të Ngarkesave për Gjeneratorët e Rregulluar, brenda tetë (8) dite pas pranimit, ta publikojë në faqen zyrtare elektronike të saj.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar